



RAPORTI VJETOR 2012

Gjatë vitit 2012 Biblioteka “Hivzi Sulejmani” ka shënuar rezultate të kënaqshme në realizimin e shërbimeve si: hartimin e projekteve për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj, përpunimin e librit, shërbimin me lexues, aktivitete të ndryshme kulturore, botimin dhe promovimin e monografisë së bibliotekës etj.

7 Marsi, Dita e Mësuesit.

Kjo bibliotekë, gjithëherë i ka dhënë rëndësi kësaj feste duke ftuar dhe nderuar ata të cilët kanë kontribuar në edukimin dhe përhapjen e diturisë të shumë gjenerata. Ketë herë, e ftuar nderi ishte zonja Minire Veliu, mësuese me një përvojë të gjatë në fushën e arsimit dhe kulturës. Ajo punon në shkollën fillore “Hasan Prishtina” dhe bashkë me nxënësit e saj është frekuentuese e rregullt e bibliotekës “Përrallat” në Ulpianë

Stafi i bibliotekës përgatiti një dokumentar të shkurtër ku ajo foli për përvojën e gjatë në edukimin e brezave të rinj dhe për dashurinë e madhe për profesionin dhe nxënësit e saj.

Drejtorja e bibliotekës i dorëzoi një Mirënjohje për kontributin e dhënë në edukimin e shumë gjenerata nxënësish.

Ky aktivitet u pasurua me poezi dhe ese kushtuar mësuesve dhe nënave, të shkruara nga lexuesit e bibliotekës. Pati edhe pika të ndryshme muzikore të cilat e begatuan rrjedhën e programit.

Sylejman Pireva: Biblioteka publike “Hivzi Sulejmani” e Prishtinës (1945-2010), Prishtinë, Biblioteka publike “Hivzi Sulejmani”, 2011

Më 29. III. 2012, ditë e enjte, Biblioteka publike “Hivzi Sulejmani” e Prishtinës bëri promovimin e librit monografik me të njëjtin titull të autorit dhe punonjësit shumëvjeçar të kësaj biblioteke, Sylejman Pireva. Interesimi i publikut për të dëgjuar fjalën e referuesve përkitazi me librin e autorit dhe vetë autorin, si dhe për këtë institucion, ishte i kënaqshëm. Pjesëmarrësit, me një fjalë rasti, i përshëndeti drejtori i Bibliotekës, Munish Hyseni, duke paraqitur edhe disa të dhëna të nevojshme për biografinë e autorit dhe angazhimin e tij në lëmin e bibliotekarisë, por edhe

format e tjera të krijimtarisë së shkruar, si dhe për rëndësinë e kësaj monografie që mund të ketë për historikun e Bibliotekës së lartpërmendur dhe për të gjithë ata që ndonjëherë tregojnë interesim për t'u marrë me të.

Për këtë libër fjalën e tyre të përgatitur enkas për këtë promovim e lexuan dy recensentët, Tahir Foniqi dhe Qazim Namani, duke i bërë një analizë dhe vështrim në diakroni dhe sinkroni kësaj monografie, që sipas tyre diçka e tillë i ka munguar fushës së bibliotekarisë. Ata nuk kursyen as fjalët e mira për angazhimin dhe përkushtimin e autorit në kuadër të veprimtarisë së përgjithme bibliotekare, si dhe suksesin e arritur përmes botimit të këtij libri.

Nga ana e pjesëmarrësve për diskutim u paraqit ish punonjësja e vjetër e kësaj biblioteke (në pension), Hajrie Peshku, e cila shkurtimisht preku disa nga problemet dhe vështirësitë e përjetuara gjatë punës shumëvjeçare në këtë institucion, por edhe rezultatet e arritura në stabilizimin e gjendjes në disa drejtime, veçmas pas përfundimit të luftës, ku edhe ajo pajtohet me mendimin e autorit të librit, se vërtet kjo ishte periudha e rilindjes së Bibliotekës.

Në fund, sipas zakonit, e mori fjalën autori i librit, i cili i përshëndeti dhe falënderoi pjesëmarrësit (siç i quajti ai miqtë e librit), duke i njoftuar shkurtimisht për përpjekjet e tij gjatë punës për të realizuar dhe kurorëzuar mundin e tij, kurse botimin e këtij libri ai e quajti një kontribut modest, por të dobishëm për studiuesit e ardhshëm, si dhe për vetë punonjësit e kësaj biblioteke.

Në fund, përfaqësuesve të bibliotekave të Kosovës ju dhanë falas nga pesë ekzemplarë të këtij libri, kurse pjesëmarrësve nga një.

2 prilli- Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë e të Rinj

Me 2 prill 2012, në bibliotekën “Hivzi Sulejmani” u festua 2 prilli “Dita Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë dhe të Rinj”, datë që përkon me lindjen e shkrimtarit të famshëm danez për fëmijë Hans Kristian Andersen.

Është emocionuese të mendosh që sot miliona fëmijë lexuan të njëjtin mesazh, shikuan të njëjtin poster, u ndjen kështu më pranë njeri tjetrit. Sesioni kombëtar i Meksikës sivjet ishte sponsore e mesazhit dhe posterit. Posterit është realizuar nga Juan Gedovius, ndërsa mesazhin e ka shkruar shkrimtari Francisco Finojosa dhe titullohet: Na ishte njëherë e një kohë një përrallë që e tregonte e gjithë bota i cili u lexua para pjesëmarrësve.

Të pranishmit i përshëndeti drejtori e bibliotekës “Hivzi Sulejmani” zotëri Munish Hysenin i cili foli për rëndësinë që ka kjo ditë në stimulimin e të rinjve për lexim.

Te pranishëm ishin edhe Karvani i shkrimtarë të cilët na kanë shoqëruar me librat dhe krijimet e tyre në hapat e jetës sonë. Pjesë nga krijimtaria e tyre lexuan: Arif Demolli, Xhevat Sylja, Ibrahim Kadriu Shefqete Godanci, Jonuz Fetahu dhe Sylejman Pireva

Me qëllim të nxitjes së dashurisë për librin dhe leximit tek nxënësit, Biblioteka “Hivzi Sulemani” ka shpallur konkurs për ese që ka të bëjë me librin dhe leximin, të cilin e ka shpërndarë nëpër shkollat fillore të Komunës së Prishtinës. Interesimi i nxënësve ka qenë jashtëzakonisht i madh.

Një komision i përbërë nga tre shkrimtarë të njohur për fëmijë: Xhevat Syla, Arif Demolli dhe Sylejman Pireva i ka vlerësuar esetë dhe ka shpallur fituesit e këtij konkursi:

- Vendi i 1- Nita Krasniqi nxënëse e klasës VI/1 në shkollën e mesme të ulët “Meto Bjaraktari të Prishtinës. Tregimi mban titullin “Magjia e librit”
- Vendi i 2- Trëndelina Zhitia, nxënëse e klasës IX/6 në shkollën e mesme të ulët “Gjergj Fishta” të Prishtinës. Tregimi mban titullin “Drejt shtigjeve të reja”
- Vendi i 3 – Sihana Hoxha, nxënëse e klasës IX/4 në shkollën e mesme të ulët Ismail Qemajli” të Prishtinës me punimin me titull “Libri dhe vlerat e tij”
Kaltrina Mustafa, nxënëse e klasës VIII/4 në shkollën e mesme të ulët “Nazmi Gafurri”, të Prishtinës me punimin “Libri është ar”.

Vendi i parë u shpërblye me 120 €, vendi i dytë me 90 € dhe vendin e tretë e ndanë dy konkurrese me nga 30 € .

Aktiviteti i dytë u zhvillua në shkollën “Xhavit Ahmeti” të Prishtinës, ku u bë përrurimi, përkatësisht hapja e bibliotekës me një fond shumë të pasur të librave, që është bërë në bazë të projektit bashkëpunues Biblioteka e Qytetit – Drejtorja e Kulturës –Drejtorja e Arsimit.

Shiritin e hapjes së bibliotekës e preu Z. Isa Mustafa – kryetarë i Komunës së Prishtinës i cili përgëzoi ata që kontribuuan për hapjen e kësaj biblioteke dhe premtoi se do të angazhohet edhe më tutje për pasurimin e bibliotekave me koleksione dhe hapjen e bibliotekave të reja.

Libra për bibliotekën dhuruan: Drejtorja për Kulturë e komunës së Prishtinës, Biblioteka “Hivzi Sulejmani”, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Shtëpia botuese “Rozafa”

Trajnime

Biblioteka Ndërkomunale “Hivzi Sulejmani “ e qytetit të Prishtinës, përmes OJQ-së “Miqte e Librit dhe Bibliotekës”, në muajin tetor të vitit 2011 ka fituar një donacion nga Ambasada Amerikane në Kosovë në vlerë prej 29 ,913.25 dollarë amerikan për realizimin e projektit “Library Collections@ Your Screen”.

Një kontribut të rëndësishëm në mbarëvajtjen e projektit ka ofruar në vazhdimësi edhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, përmes ofrimit të hapësirave për trajnim, ofrimin e infrastrukturës teknologjike për programin softuerik të bibliotekës e deri te bashkëfinancimi i ekspertëve për trajnime të veçanta.

Përmes këtij projekti, përdoruesit e bibliotekës dhe të gjithë banorët e Prishtinës do të informohen më shpejt, më mirë dhe do të kenë qasje online në informacionet e të gjitha materialeve që i posedon biblioteka.

Në kuadër të projektit janë zhvilluar edhe një varg trajnimesh për bibliotekar, si trajnimi në përdorimin e modulit të katalogimit, pastaj edhe të modulit të huazimit. I një rëndësie të veçantë është edhe trajnimi në fushën e katalogimit, e udhëhequr nga ekspertja amerikane Rebecca L. Lubas, drejtoreshë e shërbimeve të katalogimit dhe të kërkimit nga Biblioteka e Universitetit të New Mexicos (Nju Meksiko), i cili po mbahet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës prej datës 17 deri 20 prill 2012.

Trajnimi ka për qëllim njohjen me praktika të ndryshme dhe të reja të katalogimit në institucione të ndryshme bibliotekare dhe përshtatjen e tyre sa më mirë për nevojat e bashkësisë bibliotekare të Kosovës. Gjatë trajnimit janë trajtuar një varg temash të ndryshme, duke përfshirë: standardin e përshkrimit bibliografik AACR2 dhe formatin MARC; përcaktueset korporative; emrat dhe përcaktueset gjeografike; përcaktueset lëndore; katalogimi i veprave shumëvëllimëshe, materialeve audio-vizuale, hartave; pastaj bibliotekat digjitale në Dspace; gjuhët e ndryshme të metadave; gjenerata e ardhshme e standardeve bibliotekare në RDA, etj.

Në trajnim morën pjesë afër njëzet bibliotekar katalogues nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, nga biblioteka “Hivzi Sulejmani” në Prishtinë, dhe nga biblioteka e Prizrenit.

Në bibliotekën “Hivzi Sulejmani” ka kërkesa të vazhdueshme të personave që dëshirojnë ta njohin profesionin e bibliotekarisë. Këto trajnime zgjasin nga dy deri në katër javë. Pas përfundimit ata pajisen me një që certifikatë të lëshuar nga drejtoria ku dëshmohet se ata kanë fituar njohuri nga lëmi i bibliotekarisë. Në vitin 2012 ka pasur 5 trajnime të tilla.

Ka vazhduar bashkëpunimi me Shërbimin Sprovues të Kosovës. Gjatë vitit 2012 kemi pasur tre të mitur që i kanë mbajtur orët e obliguara të punës në bibliotekën tonë.

Dita botërore e librit dhe e të drejtave të autorit

Me 23 prill, 2012, në ditën botërore të librit dhe të drejtave të autorit, në sheshin Nënë Tereza, u organizuan një mori aktivitete të ndryshme që kishin të bëjë me librin dhe leximin.

Kjo datë, që shënohet që nga viti 2003, i dedikohet autorëve dhe librave nga e mbarë bota duke i inkurajuar kështu të gjithë, e në veçanti të rinjtë që të zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit dhe të fitojnë një respekt të ri për kontributin e pamohueshëm të atyre të cilët dhanë aq shumë për zhvillimin kulturor të njerëzimit.

Qendra për zhvillimin e arteve- ARTPOLIS, me përkrahjen e donatorëve (Bashkimi Europian, MKRS) ka realizuar disa aktivitete: Regjistrimi pa pagesë në bibliotekën “Hivzi Sulejmani” dhe shpallja e lexuesve më të dalluar të vitit 2012, shfaqje teatrale për fëmijë, takim me poetë për

fëmijë, shfaqja e tre filmave në kino ABC, Nata e poezive nga autorë vendas e të huaj në interpretim të aktorëve dhe instrumentistëve profesionist dhe Këndi i librit- shitja e librit me çmime të volitshme nga shtëpitë tona botuese.

Biblioteka Hivzi Sulejmani ka regjistruar pa pagesë 370 lexues të moshave të ndryshme: parashkollorë, nxënës, student, punëtor shkencorë, pensionist etj.

Ndërsa lexues më të dalluar u shpallën:

Rinor Maliqi, kl. III - “Meto Bajraktari”

Erjon Krasniqi, kl. IV- “Hasan Prishtina”

Arianit Preniqi, kl. V- “Hasan Prishtina”

Elmira Sadria, kl. IX- “Gjergj Fishta”

Imba Rudaku, studente- Fakulteti ekonomik

Drejtori i bibliotekës z. Munish Hyseni ndau nga një mirënjohje për lexuesit e dalluar , ndërsa shtëpitë botuese dhuruan libra për ta.

Biblioteka publike e Durrësit, në vazhden e “Javës e Letërsisë së krijuesve nga Kosova” bëri promovimin e monografisë së Bibliotekës publike “Hivzi Sulejmani” të Prishtinës

Në shenjë respekti dhe bashkëpunimi midis dy bibliotekave, Biblioteka publike “Naim Frashëri” e Durrësit, më 10. V. 2012, ditën e enjte, bëri përrurimin e librit monografik “Bibliotekës publike “Hivzi Sulejmani” e Prishtinës (1945-2010) të autorit Sylejman Pireva, koordinator dhe punonjës shumëvjeçar i kësaj biblioteke.

Pas promovimit të këtij libri muaj më parë nga Biblioteka publike e Prishtinës, kësaj i ishte bërë ftesë nga Biblioteka publike e Durrësit që këtë ta bëjë edhe në ambientet e saj.

Nga ana e Bibliotekës së Prishtinës morën pjesë drejtori i kësaj biblioteke, Munish Hyseni, autori i librit Sylejman Pireva, recensenti i librit Qazim Namani dhe zyrtari i Komunës së Prishtinës, Shefik Dalladaku.

Të dhëna për autorin e librit, Sylejman Pireva, paraqitën drejtorja e Bibliotekës së Durrësit, znj. Flora Dërvishi dhe z. Munish Hyseni, e para duke e çmuar autorin e librit dhe gjithë periudhën e

bashkëpunimit më të hershëm ndërmjet dy bibliotekave si dhe mbresat e mira nga kjo që nga koha e përfundimit të luftës së fundit, kurse i dyti duke e vlerësuar punën e gjithanshme të autorit të librit dhe rëndësinë e këtij bashkëpunimi për të vazhduar edhe në të ardhshmen.

Për vlerën dhe rëndësinë e monografisë së lartpërmendur, fjalën të përgatitur enkas për këtë rast e paraqitën Dila Lulja dhe Enton Bido, punonjës të Bibliotekës së Durrësit, si dhe Qazim Namani, recensent i këtij libri, të cilët në mënyrë analitike dhe përmbledhëse kishin çmuar lart vlerën dhe rëndësinë e kësaj monografie si dhe kontributin e autorit.

Në fund të kësaj, autori i librit S. Pireva, paksia i emocionuar, falënderoi organizatorin për promovimin e librit të tij, referuesit me fjalën e paraqitur dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë, duke shprehur në vazhdimin e mëtejshëm midis dy bibliotekave.

Ceremonia përmbyllëse e projektit “Biblioteka në ekranin tuaj”

Më 28.06.2012, në bibliotekën “Hivzi Sulejmani” u mbajt ceremonia përmbyllëse e projektit Library Collections@Yuor Screen (Biblioteka në ekranin tuaj) i financuar nga ambasada e SHBA-ve në Kosovë, me vlerë prej 29.913.25 \$ i realizuar nga fondacioni “Miqte e librit dhe bibliotekës” në bashkëpunim me bibliotekën “Hivzi Sulejmani”, i mbështetur nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunes së Prishtinës.

Të pranishëm në ceremoni z. Elie Techman, - zyrtar për informim në Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë, Vlora Dumoshi- drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunes së Prishtinës, dr. Sali Bashota- drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe përfaqësues të bibliotekave tjera të Kosovës.

Drejtori i bibliotekës z. Munish Hyseni foli për rëndësinë e projektit dhe ecurinë e realizimit të tij duke falënderuar të gjithë ata që kontribuan që ky projekt të realizohet me sukses: Ambasadën Amerikane në Prishtinë për këtë ndihmë financiare, e cila ka peshë dhe rëndësi të veçantë; fondacionin Miqtë e Librit dhe Bibliotekës për kontributin e dhënë në këtë projekt që nga fillimi në procesin e aplikimit për këtë ndihmë financiare e deri në përfundim në realizimin me sukses të projektit; Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për mbështetjen e pakursyer me teknologji, me hapësirë, me përvojën e tyre; Komunen e Prishtinës për përkrahjen e nismave tona dhe mbështetjen e mëtejme të mirëmbajtjes së këtyre shërbimeve.

„Bëni bashkë fëmijët dhe librat”

Këto ditë u mbajt seminari mbarëkombëtar nga lëmi i bibliotekarisë në Prishtinë nën udhëheqjen e zonjës Ute Hachmann (Biblioteka e Qytetit Brilon, Gjermani), organizuar nga Instituti Goethe në Beograd dhe Selanik.

Në këtë organizim së bashku ka kontribuar koordinatori i Bibliotekës publike “Hivzi Sulejmani”

të Prishtinës, Sylejman Pireva, që nga momenti i propozimit të idesë e deri në realizim.

Në këtë seminar, i cili zgjati 1.5 ditë, morën pjesë punonjës dhe udhëheqës të bibliotekave publike nga Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Gjiçani, Peja, Ferizaj, Elbasani, Durrësi, Ulqini, Shkup, Tetova etj. Për mbarëvajtjen e workshopit dhe për të gjitha çështjet organizative ishte përgjegjëse zonja Ute Hachmann.

Tema bosht e këtij seminari ishte „Bëni bashkë fëmijët dhe librat: Koncepte dhe ide për nxitjen e leximit të fëmijët e moshës parashkollore dhe të shkollës fillore”. Pjesëmarrëset (ishin të gjitha femra) kishin vlerësuar se tema ishte mjaft e qëlluar, kur të gjithë e pranojnë se interesimi për lexim të librit ka rënë dukshëm në krahasim me të kaluarën...

Vetë fakti që nga ana e organizatorit ishte përzgjedhur kjo temë, tregonte se kjo është e pranishme thuaja se kudo. Ligjërueset e seminarit treguan gjithë aftësitë dhe përvojën e tyre dhe nga ajo çfarë demonstroi para seminaristëve, dëshmuoi bindshëm se ekzistojnë mundësitë që interesimi për librin dhe leximin mund të zgjohet kurdoherë nëse arrihet të futen në përdorim format dhe metodat adekuate dhe të larmishme gjatë kontakteve dhe punës me fëmijë, duke filluar prej atyre të moshës parashkollore e deri te ajo e fëmijëve më të rritur.

Panairi i 15-të i Librit Tirana 2012

Biblioteka “Hivzi Sulejmani” e Prishtinës edhe këtë vit mori pjesë në Panairin të 15-të të librit në Tiranë. Me përkrahjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Prishtinës, një grup i punëtorëve të bibliotekës në krye me drejtorin Munish Hyseni, mori pjesë në Panairin e librit Tirana 2012, që është ngjarja më e rëndësishme kulturore e librit në trojet shqiptare. Panairi u mbajt me 12-18 nëntor 2012.

Në këtë Panair biblioteka u pasurua me tituj më të rinj të botuar vitin e fundit, si nga letërsia shqipe ashtu edhe nga letërsia e huaj për të plotësuar kërkesat e lexuesve të kryeqytetit.

Panairi i Librit të Tiranës, prej vitesh është vendtakimi më i madh dhe më i rëndësishëm i autorëve dhe botuesve shqiptarë nga të gjitha trevat.

Promovimi i librit “Rrënjë dashurie” të shkrimtarit nga Shkodra

Këto ditë (më 28. 09. 2012) Biblioteka publike “Hivzi Sulejmani” e Prishtinës bëri promovimin e librit “Rrënjë dashurie- Shkodranët për Kosovën” të autorit Isa Alibali nga Shkodra. Ishte vetë autori që kishte propozuar dhe shfaqur dëshirën për realizimin e këtij promovimi nga ky institucion. Ky ishte një aktivitet i radhës i organizuar nga ana e Bibliotekës publike “Hivzi Sulejmani” e Prishtinës, nën drejtimin e koordinatorit të Bibliotekës, Sylejman Pireva, që njëherazi ishte edhe moderator i promovimit.

Për librin dhe autorin folën recensenti Haki Kasumi, Izber Hoti dhe Ramiz Kelmendi, por edhe disa miq të tij, duke evokuar momente emocionale gjatë bashkëpunimit dhe kontakteve të mëhershme me autorin, atëherë kur raportet me Shqipërinë nuk ishin sikurse sot. Për librin u folën fjalë të mira dhe u cilësua si një krijim i veçantë dhe rrallëherë i hasur në letrat tona.

Pjesëmarrja e atyre që kishin aderuar për ta nderuar autorin e këtij libri mbi 72 vjeçar, ishte e kënaqshme. Autorin e këtij libri, z. Isa Alibali, e përshëndeti drejtori i Bibliotekës Munish Hyseni, duke i uruar shëndet dhe sukses në punën krijuese, duke vazhduar pa reshtur edhe botime të librave të tjerë.

Promovimi i librit u organizua në sallën e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.

Promovim i librit “Petro Nini Luarasi” 23 Nëntor 2012

Filozofi dhe studiuesi i letërsisë Alfred Uçi të enjten e promovoi në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Prishtinë librin e tij më të ri kushtuar njëres prej figurave më të ndritura të Rilindjes Kombëtare, njëherazi edhe gjyshit të tij, Petro Nini Luarasit.

Ky promovim u organizua nga Drejtoria për Kulturë e Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me bibliotekën “Hivzi Sulejmani”. Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i bibliotekës Z. Munish Hyseni.

“Kjo veprimtari bëhet edhe më e veçantë sepse zhvillohet në kuadër të 100 vjetorit të themelimit të shtetit shqiptar. Në këtë kuptim personaliteti i Petro Nini Luarasit, i Negovanit, i Pandeli Sotirit dhe shumë të tjerëve për shqiptarët kanë shërbyer si model, si përpjekje, si betejë e pandërprerë për arsimin shqip dhe lirinë, dy idealet më të mëdha që kurrë nuk u shuan në këto troje”- theksoi Munish Hyseni.

“Duke qenë se jetën dhe veprën e Petro Nini Luarasit e kam njohur mirë, mund ta kisha shkruar shumë kohë më parë librin që na ka mbledhur bashkë sot këtu, nga ndrojtja që kam pasur se mos pa dashur mund ta ngarkoja me lëvdata të tepuara, siç ndodh shpesh kur shkruan nipi për gjyshin e vet. Por, koha me rrjedhën e saj të pandalshme bën të vetën dhe të imponohet të mos ikësh pa e plotësuar një peng që të ka ndjekur tërë jetën aktive”, tha më këtë rast Akademik Uçi.

I pranishëm në promovim qe edhe Kryetari i Prishtinës, Isa Mustafa, i cili deklaroi se kjo është një vepër e madhe dhe e rëndësishme.

“Kjo ngjarje është një rast i veçantë për ne, sepse në këtu po veçojmë një dijetar dhe atdhetar, i cili do të jetë tanimë prezent në shkollat tona. Në këtë do ta zhvillojmë me përkushtimin me të madh”, tha Mustafa.

Në aktivitetin që u zhvillua në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, Uçi tha se ka sjellë rreth 200 kopje të këtij libri për t’ua shpërndarë shkollave në Kosovë.

100 vjet Pavarësi

Në Bibliotekën Përkujtimore- degë e bibliotekës Hivzi Sulejmani u shënua festa e flamurit dhe 100 vjetori i themelimit të shtetit shqiptar.

Ky manifestim u organizua nga librarët e kësaj biblioteke në bashkëpunim me lexuesit , të cilët gjithherë janë të gatshëm të kontribuojnë në raste të tilla. Këtij manifestimi i parapriu një kronologji e ngjarjeve më të rëndësishme që e përcollën popullin shqiptar që nga viti 1912 e deri në ditët e sotme e përgatitur nga librarja e kësaj biblioteke Bukurije Demolli. Në vazhdim të programit u kënduan këngë për flamurin dhe në fund vajzat kërcyen Vallen e Pavarësisë. Pjesëmarrja e nxënësve të shkollave të ndryshme ishte e madhe. Ata ishin veshur kuq e zi, si simboli i flamurit tonë.

Pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj

Biblioteka “Hivzi Sulejmani” në vitin 2012 është pasuruar me këto fonde:

projekti për libra nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Prishtinës me 432 tituj 3415 ekzemplarë

Panairi i librit në Prishtinë 22 tituj 100 ekzemplarë

Panairi librit në Tiranë me 90 tituj 332 ekzemplarë

Dhuratë nga Koha ditore me 68 tituj 639 ekzemplarë

Dhuratë nga Logos A me 139 tituj 1996 ekzemplarë

Dhurata të ndryshme me 56 436 ekzemplarë

Gjithsej: Të blerë : 544 tituj me 3847 ekzemplarë

Të dhuruar: 263 tituj me 2071 ekzemplarë

Gjithsejtë biblioteka “Hivzi Sulejmani” në vitin **2012** është pasuruar me **807** tituj dhe **6537** ekzemplarë

Zgjerimi i rrjetit bibliotekar

Hapja e bibliotekës në shkollën fillore “Xhavit Ahmeti” me një fond shumë të pasur të librave, që është bërë në bazë të projektit bashkëpunues Biblioteka e Qytetit – Drejtoria e Kulturës – Drejtoria e Arsimit dhe radhitja e fondit nga punëtorët e bibliotekës “Hivzi Sulejmani”.

Projekt për libra për shkollën fillore “Shkolla e gjelbër” me 540 tituj dhe 397 ekzemplarë

Projekt për libra për Gjimnazin “ Xhevdet Doda” me 488 tituj dhe 1110 ekzemplarë

Dhuratë për bibliotekën në Medvegjë me një fond : 84 tituj me 124 ekzemplarë

Botimet

Në kuadër të projektit “Library Collections@Yuoer Screen”(Biblioteka në ekranin tuaj) u botua iudhëzuesi informativ i shërbimeve elektronike të bibliotekës “Biblioteka në ekranin tuaj” 2012, cilin e përgatiti Fatime Mehmetaj. Ky udhëzues ka 30 faqe dhe iu shërben përdoruesve në kërkimin e materialeve elektronike të bibliotekës. Redaktor Munish Hyseni, dizajni Bujar Hajrizi.

Në fund të vitit 2013 u botua libri me tregime “Libri po të pret, kërkije!” 195 f. 2012 nga konkursi letrar i shkollave të Prishtinës në Ditën Ndërkombëtare të Librit për fëmijë e të Rinj. Botues Biblioteka “Hivzi Sulejmani”, redaktor Munish Hyseni.

Prishtinë

17.01.2013

Drejtori

Munish Hyseni